

20211031637

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË PAGESËS SË PENSIONEVE
DHE TË KOMPENSIMEVE PENSIONALE NGA SIGURIMI PENSIONAL ME
FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin e Pagesës së Pensioneve dhe të kompensimeve Pensionale nga Sigurimi Pensional me Financim Kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 11/12, 147/15 dhe 30/16), në nenin 2 pas pikës 22 shtohet pikë e re 23, e cila bëhet:

“23. “Person përgjegjës për kundërvajtje” është:

a) anëtar i këshillit drejtues dhe/ose anëtar i këshillit mbikëqyrës të shoqërisë apo person i autorizuar prej tij;

b) anëtar i organit për menaxhim dhe/ose anëtar i organit mbikëqyrës i shoqërisë për sigurim apo person i autorizuar prej tij;

c) anëtar i organit për menaxhim dhe/ose anëtar i organit mbikëqyrës i shoqërisë për sigurim apo person i autorizuar prej tij;

ç) anëtar i organit për menaxhim dhe/ose anëtar i organit mbikëqyrës i shoqërisë për përfaqësim në sigurim apo person i autorizuar prej tij;

d) drejtor apo udhëheqës i njësisë organizative, përgjegjës për ruajtje të pronës së rojtarit të pronarit apo person i autorizuar prej tij;

dh) drejtor, ndihmësdrejtor apo person tjetër në pozitë udhëheqëse në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

e) drejtor i Qendrës së Kotimit apo person i autorizuar prej tij.”.

Neni 2

Neni 81 ndryshohet dhe bëhet:

“Kompensim dhe marrëveshje për kundërvajtjen

(1) Dispozitat e Ligji të Sigurimit të Detyrueshëm Pensional me Financim Kapital të cilat kanë të bëjnë me kompensim do të aplikohen në procedurat në lidhje me kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj.

(2) Dispozitat e Ligjit të Supervizionit të Sigurimit të cilat kanë të bëjnë me ndërmjetësim dhe marrëveshje do të aplikohen në procedurat në lidhje me kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj.”.

Neni 3

Neni 82 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 4.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për sigurim, nëse:

1) gjatë përcaktimit të shumës së anitetit të prolonguar vepron në kundërshtim me nenin 9 paragrafi (2) të këtij neni;

2) nuk e harmonizon shumën e anitetit që do të paguhet në pajtim me nenin 12 paragrafi (1) të këtij ligji;

3) nuk parashtron të dhëna statistikore në ASS në periudhë dhe formë të përcaktuar nga ASS në pajtim me nenin 22 paragrafi (4) të këtij ligji, dhe

4) nuk parashtron të dhëna statistikore në ASS në periudhë dhe formë të përcaktuara nga ASS në pajtim me nenin 63 paragrafi (4) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtjet sipas paragrafit (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në shoqërinë e sigurimit.

(3) Gjobë deri në shumë të dyfishtë sipas paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet shoqërisë për sigurim nëse me kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni ka fituar dobi më të madhe pronësore apo ka shkaktuar dëm më të madh.

(4) Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë nen procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykatë kompetente.”.

Neni 4

Neni 83 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Gjobë në shumë prej 3.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për sigurim, nëse:

- 1) e prish polisën për anuitet të harmonizuar në nenin 4 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 2) bën harmonizim të anuitetit fiks të harmonizuar me shpenzime për jetë në kundërshtim me nenin 6 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 3) ofron diskont, kthim të mjeteve monetare apo volitshmëri tjera në kundërshtim me nenin 7 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 4) inkason kompensime në kundërshtim me nenin 10 të këtij ligji;
- 5) përllogarit lartësi të pensionit për shtyllën e dytë nëpërmjet anuitetit fiks me pjesëmarrje në fitim në kundërshtim me nenin 11 paragrafët (1) dhe (4) të këtij ligji;
- 6) nuk prezanton ofertë në afatin e përcaktuar në nenin 30 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 7) nuk e bën pagesën e parë të anuitetit në afat të përcaktuar në nenin 36 paragrafi (3) të këtij ligji;
- 8) nuk e njofton Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut në pajtim me nenin 38 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 9) nuk e kontrollon lartësinë e pensionit nga shtylla e dytë në pajtim me nenin 39 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 10) nuk bën kontrolle në pajtim me nenin 40 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 11) bën pagesë të anuiteteve në kundërshtim me nenin 49 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 12) nuk bën reduktim të tatimit gjatë pagesës së pensioneve nga shtylla e dytë dhe të kompensimeve të pensionit nga shtylla e tretë në pajtim me nenet 50 dhe 79 të këtij ligji;
- 13) anulon polisë për anuitet të harmonizuar në nenin 53 paragrafi (1) të këtij ligji;
- 14) ofron diskont, kthim të mjeteve monetare apo volitshmëri tjera në kundërshtim me nenin 55 paragrafi (2) të këtij ligji;
- 15) inkason kompensime në kundërshtim me nenin 57 të këtij ligji;
- 16) nuk e bën pagesën e parë të anuitetit në afat të përcaktuar në nenin 74 paragrafi (3) të këtij ligji;
- 17) nuk e harmonizon në mënyrë proporcionale shumën e anuitetit në mënyrë të përcaktuar me nenin 75 të këtij ligji, dhe
- 18) bën pagesë të anuiteteve në kundërshtim me nenin 78 paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë denari do të shqiptohet për kundërvajtjet sipas paragrafit (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në shoqëri për sigurim.

(3) Gjobë deri në shumë të dyfishtë sipas paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet shoqërisë për sigurim nëse me kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni ka fituar dobi më të madhe pronësore apo ka shkaktuar dëm më të madh.

(4) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.”.

Neni 5

Neni 84 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Gjobë në shumë prej 8.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për sigurim, nëse:

1) paguan lloj të pensionit nga shtylla e dytë apo kompensim pensional nga shtylla e tretë në kundërshtim me nenet 3 dhe 52 të këtij ligji;

2) nuk përdor tabela për vdekshmëri në pajtim me nenin 22 paragrafi (2) të këtij ligji;

3) nuk përdor norma interesi në pajtim me nenin 22 paragrafi (6) të këtij ligji;

4) nuk përdor tabela për vdekshmëri në pajtim me nenin 63 paragrafi (2) të këtij ligji dhe

5) nuk i përdor normat e interesit sipas nenit 63 paragrafi (6) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 400 deri 500 euro në kundërvlerë denari do të shqiptohet për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në shoqëri për sigurim.

(3) Gjobë deri në shumë të dyfishtë të shumës sipas paragrafit (1) të këtij neni do t’i shqiptohet shoqërisë për sigurim nëse me kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni ka fituar dobi më të madhe pronësore apo ka shkaktuar dëm më të madh.

(4) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykatë kompetente.”

Neni 6

Neni 85 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 4.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për pensionim, nëse:

1) nuk parashtron të dhëna statistikore në ASS në periudhë dhe formë të përcaktuar nga ASS në pajtim me nenin 22 paragrafi (4) të këtij ligji,

2) nuk mban dhe nuk ruan evidencë në mënyrë të përcaktuar në nenin 37 paragrafi (1) të këtij ligji;

3) nuk parashtron të dhëna statistikore në MAPAS në periudhë dhe në formë të përcaktuara nga MAPAS në pajtim me nenin 63 paragrafi (4) të këtij ligji, dhe

4) nuk mban dhe nuk ruan evidencë në mënyrë të përcaktuar në nenin 76 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë denari do të shqiptohet për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në shoqëri për pensionim.

(3) Gjobë deri në shumën e dyfishtë sipas paragrafit (1) të këtij neni do t’i shqiptohet shoqërisë për pensionim nëse me kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni ka fituar dobi më të madhe pronësore apo ka shkaktuar dëm më të madh.

(4) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykatë kompetente.”

Neni 7

Neni 86 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Gjobë në shumë prej 3.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për pensionim, nëse:

1) nuk përcakton person i cili ka leje për punë si ekspert i sigurimeve i autorizuar në pajtim me nenin 15 paragrafi (2) të këtij neni;

2) gjatë përlllogaritjes së parë për tërheqje të programuara përdor parametra dhe formulë në kundërshtim me nenin 16 paragrafët (2) dhe (4) të këtij ligji;

3) gjatë përlllogaritjes së sërishme për tërheqje të programuara përdor parametra dhe formulë në kundërshtim me nenin 16 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji;

- 4) inkason kompensime në kundërshtim me nenin 2 paragrafi (17) të këtij ligji;
 - 5) nuk bën kontroll të shumës së pensionit në pajtim me nenin 20 paragrafi (5) të këtij ligji;
 - 6) nuk parashtron kërkesë për kotim në pajtim me nenin 29 paragrafi (3) të këtij ligji;
 - 7) nuk prezanton ofertë në afatin e përcaktuar në nenin 30 paragrafi (1) të këtij ligji;
 - 8) nuk përdor tabelë të përmbledhjeve në pajtim me nenin 32 paragrafi (1) të këtij ligji;
 - 9) inkason kompensime për transfer të mjeteve në kundërshtim me nenin 36 paragrafi (1) të këtij ligji;
 - 10) nuk i transferon mjetet në afatin e përcaktuar në nenin 36 paragrafi (2) të këtij ligji;
 - 11) nuk e njofton Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut në pajtim me nenin 38 paragrafi (1) të këtij ligji;
 - 12) nuk e kontrollon lartësinë e pensionit nga shtylla e dytë në pajtim me nenin 39 paragrafi (2) të këtij ligji;
 - 13) nuk bën kontrolle në pajtim me nenin 40 paragrafi (1) të këtij ligji;
 - 14) nuk e rrit pagesën e tërheqjeve të programuara në përputhje me nenin 42 paragrafi (1) të këtij ligji;
 - 15) bën pagesa të tërheqjeve të programuara në kundërshtim me nenin 49 paragrafi (1) të këtij ligji;
 - 16) nuk e zvogëlon tatimin gjatë pagimit të pensioneve të shtyllës së dytë dhe kompensimeve pensionale të shtyllës së tretë në përputhje me nenet 50 dhe 79 të këtij ligji;
 - 17) nuk parashtron kërkesë për kotim në pajtim me nenin 67 paragrafi (7) të këtij ligji;
 - 18) nuk paraqet ofertë në përputhje me nenin 69 të këtij ligji;
 - 19) nuk paraqet tabelë përmbledhëse në përputhje me nenin 71 paragrafi (2) të këtij ligji;
 - 20) kryen transferimin e mjeteve nga llogari individuale vullnetare ose profesionale në subjekt që nuk është shoqëri sigurimi ose shoqëri pensionale në kundërshtim me nenin 74 paragrafi (1) të këtij ligji;
 - 21) nuk transferon mjetet brenda afatit të përcaktuar në nenin 74 paragrafi (2) të këtij ligji;
 - 22) nuk bën pagesën e parë të tërheqjeve të programuara brenda afatit të përcaktuar në nenin 74 paragrafi (3) të këtij ligji dhe
 - 23) bën pagesë të tërheqjeve të programuara në kundërshtim me nenin 78 paragrafi (1) të këtij ligji.
- (2) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë denari do të shqiptohet për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në shoqëri për pensionim.
- (3) Gjobë deri në shumën e dyfishtë sipas paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet shoqërisë për pensionim nëse me kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni ka fituar dobi më të madhe pronësore apo ka shkaktuar dëm më të madh.
- (4) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykatë kompetente.”.

Neni 8

Neni 87 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Gjobë në shumë prej 8.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë pensionale, nëse:

- 1) paguan lloj të pensionit nga shtylla e dytë apo kompensim pensional nga shtylla e tretë në kundërshtim me nenet 3 dhe 52 të këtij ligji;
- 2) nuk përdor tabela për vdekshmëri në pajtim me nenin 22 paragrafi (3) të këtij ligji;
- 3) nuk përdor norma interesi në pajtim me nenin 22 paragrafi (7) të këtij ligji;
- 4) nuk përdor tabela për vdekshmëri në pajtim me nenin 63 paragrafi (3) të këtij ligji, dhe
- 5) nuk i përdor normat e interesit sipas nenit 63 paragrafi (7) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 400 deri 500 euro në kundërvlerë denari do të shqiptohet për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në shoqëri për pensionim.

(3) Gjobë deri në shumën e dyfishtë sipas paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet shoqërisë për sigurim nëse me kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni ka fituar dobi më të madhe pronësore apo ka shkaktuar dëm më të madh.

(4) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykatë kompetente.”.

Neni 9

Neni 88 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Gjobë në shumë prej 3.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për përfaqësim në sigurim apo shoqërisë së brokerëve për sigurim, nëse:

1) ofron ulje, kthim të mjeteve monetare apo volitshmëri tjera në kundërshtim me nenin 7 paragrafi (2) të këtij ligji;

2) inkason provizion nga shoqëri sigurimi në kundërshtim me nenin 8 paragrafi (2) të këtij ligji; dhe

3) ofron ulje, kthim të mjeteve monetare apo volitshmëri të tjera në kundërshtim me nenin 55 paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në shoqëri për përfaqësim në sigurim apo në shoqëri brokerësh për sigurim.

(3) Gjobë në shumën e dyfishtë sipas paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet shoqërisë për përfaqësim në sigurim apo në shoqëri brokerësh për sigurim nëse me kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni ka fituar dobi më të madhe pronësore apo ka shkaktuar dëm më të madh.

(4) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykatë kompetente.”.

Neni 10

Neni 89 ndryshohet dhe bëhet:

“(1) Gjobë në shumë prej 3.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut, nëse:

1) nuk parashtron kopje nga aktvendimi, përkatësisht vendimit i shoqërisë pensionale në pajtim me nenin 28 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji;

2) nuk bën kontroll të dallimit të përlllogaritur deri në shumën më të ulët të pensionit në pajtim me nenin 41 paragrafi (1) të këtij ligji;

3) nuk bën pagesë të dallimit të përlllogaritur deri në shumën më të ulët të pensionit në pajtim me nenin 41 paragrafi (3) të këtij ligji;

4) nuk paguan dallim të pensionit në pajtim me nenin 42 paragrafi (2) të këtij ligji, dhe

5) nuk e paguan shumën më të ulët të pensionit në pajtim me nenin 43 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës për kundërvajtje në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor në Maqedoninë e Veriut.

(3) Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar në Fondin e sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut, nëse në afat prej tre ditëve nga dita e pranimit të kërkesës nuk vepron në pajtim me nenin 34 paragrafin (4) të këtij ligji.

(4) Gjobë deri në shumën e dyfishtë sipas paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet Fondit tër Sigurimit Pensionsal dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut nëse me kundërvajtjen sipas paragrafit (1) të këtij neni, ka fituar dobi më të madhe pronësore apo ka shkaktuar dëm më të madh.

(5) Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen, procedurë për kundërvajtje zbaton dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykatë kompetente.”

Neni 11

Neni 89-a fshihet.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.